



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË
RËNDA TIRANË

2

V E N D I M

PËR KRIJIMIN E GRUPIT HETIMORË NË HETIMIN E MATERIALIT
KALLËZUES ME NR 104/2018

Në Tiranë, sot më datën 17.05.2018.
Unë Donika Prela, Drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, pasi studiova aktet e materialit kallëzues nr: 104, regjistruar më datë 14.05.2018 për veprën penale të vepres penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike" të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal .

K O N S T A T O V A :

Më datë 14.05.2018 ne Prokurorine Prane Gjykeses se Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda Tiranë është regjistruar materiali kallëzues me nr 104 për veprën penale të vepres penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike" të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal.

Nga aktet e para hetimore rezulton se më datë 14.05.2018 në një konferencë për shtyp të organizuar në selinë e Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë është publikuar një material video. Nga biseda e bërë publike midis dy personave, njëri me identitet të rremë i cilësuar si "Bashkëpunëtori X" dhe një personi tjetër i supozuar si shtetasi Agron Xhafaj (vella i Ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj) është treguar se bashkëpunëtori është ndihmuar nga shtetasi Agron Xhafaj për të siguruar një sasi kanabisi për ta trafikuar.

Në kuadër të veprimeve urgjente hetimorë, me procesverbalin e datës 15.05.2018 është sekuestruar pranë Partisë Demoktarike, dorëzuar nga deputeti Enkelejd Alibeja, nje DVD ku gjenden materialet e bëra publike në konferencën për shtyp të Partisë Demokratike më datë 14.05.2018 si më sipër.

Me shortin manual të datës 15.05.2018, është caktuar për kryerjen e verifikimeve ne kete material kallëzues prokurore Zj. Pranvera Pustina.
Prokurorja Pranvera Pustina pasi është njohur me aktet, më datë 16.05.2018 ka paraqitur tek Drejtuesi i Prokurorisë kërkesë për heqje dorë nga hetimet e materialit kallëzues nr 104/2018 me shkakun se:

Materiali përmban të dhëna të siguruara nga mjetet elektronike të komunikimit publik, lidhur me një bisedë të regjistruar midis një personi të pidentifikuar dhe shtetasit

43

të dyshuar si Agron Xhafaj (vëllai i Ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj). Referuar subjekteve potenciale të këtij materiali kallzues, prokurorja parashtron se familjarët e saj, konkretisht bashkëshorti, ka njohje personale shoqërore me shtetasen Aulona Xhafaj, të bijën e Ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe bashkëshortin e saj.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është pranuar kërkesa për heqje dorë e Prokurores duke bërë zëvendësimin e saj me Prokurorin Z. Perparim Kulluri të caktuar me short manual.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e hetimeve dhe kompleksitetin e tyre, faktin që ky material kallzues duhet të regjistrohet si procedim penal dhe duhet të kryhen një sërë veprimesh hetimore, vlerësoj se për këtë çështje është e nevojshme të krijohet një grup hetimor.

Sa me sipër, ne mbështetje të nenit 42/1 të Ligjit nr 97/2016 "Për Organizimin dhe Funkcionimin në Republikën e Shqipërisë"

V E N D O S A

1-Krijimin e grupit hetimorë për hetimin e materialit kallzues me nr. 104/2018 për veprën penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike" parashikuar nga neni 283/a/2 i K.Penal, të përbërë nga Prokurorët Z.Perparim Kulluri caktuar me short manual hedhur sot me date 17.05.2018 dhe Prokurori Z.Gentjan Osmani, Zëvendës Drejtues i Prokurorisë.

2-Me këtë vendim të njihen Prokurorët për rakordimin e punës në kuadër të hetimeve të këtij procedimi penal.

3-Një kopje e vendimit të dërgohet në Zyrën e Regjistrimit në Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë.

DREJTUESI I PROKURORISË

DONIKA PRELA

